



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCES

Njoftim për shtyp

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike”

Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi “Raportin e grupit të punës për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” dhe “Raportin shtesë për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” të paraqitur nga Sekretariati, si edhe pas zhvillimit të seancës konsultative me përfaqësues të Entit Rregullator të Energjisë, mori me shumicë votash vendimin 159, datë 19.11. 2010 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike .

Sipas Komisionit të Konkurrencës, mirëfunktionimi i tregut të energjisë elektrike duke siguruar një furnizim të sigurt të energjisë elektrike me çmime sa më konkurruese, është një faktor kyç për të siguruar rritjen e ekonomike dhe mirëqenien e konsumatorëve.

Struktura tradicionale e sistemeve elektrike është një njësi e integruar vertikalisht, e cila shpesh është monopol natyror. Konkurrenca krijohet nëpërmjet copëtimit të kësaj strukture në pjesët e saj përbërëse, duke treguar kujdes që të identifikohen ato pjesë të cilat mund të përfshihen në mënyrë aktive në konkurrencë dhe ato veprimtari të cilat duhet të mbeten të rregulluara. Komisioni vëren se megjithëse është bërë një progres i dukshëm në këtë drejtim përsëri marrja e masave të mëtejshme për liberalizim e plotë të këtij tregu përbën një prioritet të punës së Autoritetit të Konkurrencës, i cili është shprehur nëpërmjet disa vendime me qëllimin e nxitjes konkurrencës, nga njëra anë dhe të Entit Rregullator të Energjisë nga ana tjetër.

Tregu i energjisë elektrike karakterizohet nga integrimi vertikal, prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja, të cilat realizohen nga ndërmarrjet KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ-Shpërndarje sh.a(OSSH). KESH sh.a përbëhet nga dy segmente të integruara vertikalisht të organizuara në KESH-Gen dhe Furnizuesi Publik me Shumicë, të cilat operojnë si një njësi ekonomike. Gjithashtu, CEZ-Shpërndarje përbëhet nga dy segmente të integruar vertikalisht, Shpërndarja dhe Furnizuesi Publik me Pakicë, të cilat operojnë si një njësi ekonomike.

Autoriteti i Konkurrencës është bazuar në analizën e tregut, në konkluzionet e draftuara dhe propozimet për ndërhyrje të mëtejshme në tregun e energjisë elektrike të paraqitura në raportet përkatëse për pjesën e rregulluar dhe të parregulluar të tregut të energjisë elektrike.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 28 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit, vendosi t’i rekomandojë:

Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike:

- 1 Ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut.
- 2 Ndarjen financiare reale të “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe “Furnizuesit Publik me Pakicë” në mënyrë që të operojnë si njësi të ndara financiarisht pasi këto segmente tregu janë të liberalizuara dhe është një instrument që ndikon në rritjen e konkurrencës në këtë segment të tregut.
- 3 Përsheptimin e procesit të rishikimit të Kontratës me Klientët tariforë duke përcaktuar detyrimet e Furnizuesit Publik me Pakicë për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet respektimit të treguesve të cilësisë së shërbimit (furnizimi vs mungesës së energjisë dhe saktësisë së faturimit)

Për më shumë lexoni të plotë vendimin e Komisionit të Konkurrencës të publikuar në faqen zyrtare të internetit caa.gov.al/vendime